



VENDIM

Nr.128, Datë 29.07.2016

MBI TARIFAT E SHITJES ME PAKICE TE ENERGJISE ELEKTIKE PER KLIENTET E LIDHUR NE TM DHE ME MATES NE TU PER PERIUDHEN 1KORRIK -31 DHJETOR 2016

Në mbështetje të neneve, 16; 20 gërma “c” dhe 109 pika 5, të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, VKM Nr. 244 “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrjnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, Vendimit Nr.112, datë 08.07.2016 “Për përcaktimin e të licencuarit të ngarkuar me detyrimin e shërbimit universal për tregun e energjisë elektrike dhe përcaktimin e kushteve për ushtrimin e detyrimit të shërbimit universal” dhe nenit 22 të “Rregullave të Organizimit, Funksionimit dhe Proçedurave” të ERE-s, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s Nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 29.07.2016, pasi shqyrtoi, relacionin e Drejtorive Teknike,

Konstatohet se:

- OSHEE sh.a., me shkresën Nr. 10657 Prot., datë 20.05.2016 aplikoi për tarifa për një kategori të re konsumatorësh, e cila nuk ka qenë e përfshirë në strukturën ekzistuese të tarifave, *konkretisht për konsumatorët e lidhur në TM por me matje në TU.*
- OSHEE deklaroi se një pjesë e klientëve kanë kontrata të pikëlidhjes në TM por matësa të energjisë, në pjesën pas paisjeve transformuese dhe transmetuese të cilat janë në pronësi të tyre.
- ERE me shkresën 508 Prot., datë 14.07.2015, ka adresuar tek OSHEE sh.a. zgjidhjen për këtë problematikë duke kërkuar *qëne lidhje me grupin e konsumatoreve për të cilët nuk ka mundësi të zhvendoset pika e matjes (për shkak se janë të lidhur në kabina nga të cilat furnizohen edhe kliente të tjere, kanë konsum të ulet dhe nuk plotësojnë kushtet teknike) të vazhdohet faturimi me cmimin e TU.*
- Niveli i humbjeve teknike për vitin 2016 parashikohet të jetë më i ulët se viti paraardhës.

- Në zbatim të VKM nr. 244 datë 30.03.2016 “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”. OSHEE ka detyrimin të blejë energji nga burimet e rinovueshme të energjisë për mbulimin e humbjeve“.

Për gjithë sa më sipër cituar Bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Për klientët e lidhur në TM dhe me matës në TU, të miratojë tarifën 12.4 leke/kWh për shitjen me pakicë të energjisë aktive (jo pik) për periudhën 1 Korrik -31 dhjetor 2016 nga furnizuesi universal.
2. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve të njoftojë shoqërinë OSHEE sh.a. për vendimmarrjen e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet ne Fletoren Zyrtare.

